



OJQ "Kasnecët e Ardhmërisë" – KeA, është organizatë joqeveritare e cila zbaton projektin "Fuqizimi i Kontrollit të Tuberkulozit në Kosovë", i cili projekt është i financuar nga ana e GFATM nëpërmjet të CDF (Community Development Fund). Në lidhje me këtë projekt OJQ KeA shpall konkurs për këto vende të lira pune:

1. Motrat patronazhit të TB për përpunimin e kontaktit (Gjilan, Skenderaj, Pejë)

Përgjegjësitë:

- Të bëjnë përpunimin e kontaktit të pacientëve të TB në regjionin përkatës;
- Të bëjnë regjistrimin dhe raportimin e rasteve të përpunimit të kontakteve;
- Trajtimi dhe përcjellja e trajtimit të kontakteve të identifikuar me ILTB;

Kualifikimet:

- Motra medicinale të punësuar në Klinikën pediatrike dhe burgun në burgun e Dubravës, si dhe dispanzeritë apo QKFM-të e komunave me barrë më të madhe të TB (Podujevë, Malishevë, Klinë, Lipjan, Kaçanik);
- Përvojë në përpunimin e kontaktit të TB;
- Trajnimet shtesë mbi TB do të jenë përparësi;

2. Motrat të kujdesit parësor shëndetësor për angazhim në pilot projektin për TB me fokus pacientin në Klinë, Prishtinë dhe Lipjan

Përgjegjësitë:

- Të jetë e angazhuar në përvetësimin e detyrave klinike të parapara në kontrollin e TB në kuadër të KPSH në komunën përkatëse:
 - asistimin në procedurat diagnostike të pacientëve me TB dhe ILTB (referimi i të dyshuarve për TB te pulmologu, mbledhja e sputumit për diagnozën e TB, bërja e rentgenit, Mantoux testimi, analizava tjera relevante)

- në disperzimin e terapisë për TB dhe ILTB, mbajtjen e pacientit në trajtim, monitorimin e trajtimit, sigurimin e suksesit të trajtimit, menaxhimin dhe adresimin e efekteve anësore të trajtimit për TB dhe ILTB
- Përpunimin e kontakteve të pacientëve me TB
- Të bëjë regjistrimin dhe raportimin e rasteve të TB dhe ILTB;
- Të bëjë edukimin shëndetësor të pacientëve me TB, familjarëve të tij si dhe të komunitetit
- Të gjitha detyrat dhe angazhimet tjera të parapara në kuadër të pilot projektit

Kualifikimet:

- Motra medicinale të punësuar në QKMF gjegjëse (Klinë, Prishtinë, Lipjan);
- Përvojë në punën me pacientët me TB
- Trajnimet shtesë mbi TB do të jenë përparësi;

3. Mjekët të kujdesit parësor shëndetësor për angazhim në pilot projektin për TB me fokus pacientin në Klinë, Prishtinë dhe Lipjan

Përgjegjësitë:

- Të jetë i/e angazhuar në përvetësimin e detyrave klinike të parapara në kontrollin e TB në kuadër të KPSH në komunën përkatëse:
 - Mbikqyrë dhe asistojë në procedurat diagnostike të pacientëve me TB dhe ILTB (referimi i të dyshuarve për TB te pulmologu, mbledhja e sputumit për diagnozën e TB, bërja e rentgenit, Mantoux testimi, analizava tjera relevante)
 - mbikqyrë dhe asistojë motrat në KPSH në disperzimin e terapisë për TB dhe ILTB, mbajtjen e pacientit në trajtim, monitorimin e trajtimit, sigurimin e suksesit të trajtimit, menaxhimin dhe adresimin e efekteve anësore të trajtimit për TB dhe ILTB
- Mbikqyrë përpunimin e kontakteve të pacientëve me TB
- Të bëjë apo mbikqyrë dhe asistojë motrat në regjistrimin dhe raportimin e rasteve të TB dhe ILTB;
- Të ketë bashkëpunim të ngushtë me pulmologun përgjegjës për menaxhimin e rasteve të TB
- Të bëjë edukimin shëndetësor të pacientëve me TB, familjarëve të tij si dhe të komunitetit
- Të gjitha detyrat dhe angazhimet tjera të parapara në kuadër të pilot projektit

Kualifikimet:

- Mjekë familjar të punësuar në QKMF gjegjëse (Klinë, Prishtinë, Lipjan);
- Përvojë në punën me pacientët me TB do të jetë përparësi;
- Trajnimet shtesë mbi TB do të jetë përparësi;

4. Pulmologë në kuadër të pilot projektit për TB me fokus pacientin në komunat përkatëse

Përgjegjësitë:

- Të jetë i/e angazhuar në menaxhimin klinik të dyshuarve për TB si dhe rasteve të konfirmuara të TB si dhe ILTB
- Të përcaktojë regjimin përkatës të trajtimit të TB dhe ILTB
- Të menaxhojë afektet anësore të trajtimit të TB dhe ILTB
- Të referojë rastet TB-MRB në njësinë për TB-MRB
- Të plotësojë format e regjistrimit dhe raportimit të TB
- Të jetë i gatshëm të punojë në më shumë se një qendër
- Orari do të jetë 2-3 herë në javë

Kualifikimet:

- Të jetë specialistë i pulmonologjisë
- Përvojë në punën me pacientët me TB do të jetë përparësi;
- Trajnimet shtesë mbi TB do të jetë përparësi;

5. Ekspert vendor për trajnime të ndryshme:

1 ekspert vendor për trajnimin anëtarët e komunitetit për sesione edukative

1 ekspert vendor për trajnimin e pulmonologjeve dhe të jo-pulmonologjeve mbi TB&TBEKSP

1 ekspert vendor për zhvillimin planeve të riskut për institucione të TB si dhe trajnimin e punetoreve shëndetësor dhe joshëndetësor mbi masat e kontrollit të infeksionit duke përfshirë edhe burgjet

1 ekspert vendor për trajnimin e stafit të laboratoreve

1 ekspert vendor për trajnimin e stafit të laboratoreve

1 ekspert vendor për trajnimin e punetoreve shëndetësor që merren me menaxhimin të rasteve të TB-MRB si dhe me TB në burgje

Përgjegjësitë:

- Të përgatis kurrikulën (Power Point prezantimin) për trajnim;
- Të përgatisë pre- dhe post testin, listën e evaluimit, dhe listën e pjesëmarrësve;
- Të identifikojë dhe ftojë pjesëmarrësit për workshop, trajnime dhe ritrajnime;
- Të informojë dhe kërkojë nga stafi i menaxhimit të KeA-s furnizimin me kohë, me materiale të trajnimit, freskimit, pagesat etj;
- Të përgatisë raportin e trajnimeve të realizuara, duke përfshirë edhe rezultatet e pre- dhe post testimi në zyrën e OJQ KeA;

Kualifikimet:

- Fakulteti i mjekësisë, specializimi pulmonologjisë, mikrobiologjisë, infektolog, apo lëmive tjera përketëse
- Përvoja në lëmin e caktuar (Pulmologji, Laborator të TB, financa publike, specializim në s. Infektive, shëndet publik,)
- Të ketë përvojë me Microsoft Office

6. Supervizor i rrjetit të laboratorëve të TB

Përgjegjësitë:

- Mbikëqyrni të gjitha qendrat e mikroskopisë direkte të paktën një herë në muaj.
- Të bëj kontrollin e kualitetit të mikroskopisë direkte në laboratorët periferike të TB në kuadër të qendrave diagnostikuese, me anë të paneleve testuese si dhe mostrave të rastit
- Kontrolloni evidencën që ka të bëjë me shërbimet e mikroskopisë direkte
- Kontrolli procedurat e asgjësimit të materialit të kontaminuar të laboratorit në qendrat e caktuara të mikroskopisë direkte.
- Mbikëqyrë zbatimin e të gjithë procedurave të Sigurimit të Cilësisë të laboratorit, ruajtjen e slljadeve për kontrollin e kualitetit.
- Mbikëqyrë furnizimin dhe mirëmbajtjen e regjensëve laboratorik
- Sigurohuni që ekzemplarët diagnostikues dhe përcjellës të sputumit për kulturë/TNB të dyshuarit/pacientët dërgohen në Laboratorët e Kulturës/DST sipas udhëzimeve të LRN.
- Të përpiloj raportin e supervizionit me të gjeturat dhe rekomandimet
- Çdo punë tjetër e caktuar sipas nevojës së programit

Kualifikimet:

- Të ketë specializimin e mikrobiologjisë
- Përvojë në laborator;
- Trajnimet shtesë mbi TB do të jenë përparësi;
- Të ketë patent shoferin

Konkursi mbetet i hapur deri me **30 Shtator 2022,,** në ora 12.00. CV-të të dërgohen në email-at: rinarexha28@gmail.com, orinda.hasi@gmail.com ose në zyrë të OJQ KeA. Vetëm lista e ngushtë e kandidatëve do të kontaktohet.